

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Baste të paligjshme pranë shkollave në Tiranë, zbulohet aktiviteti në 6 lokale dhe arrestohen 8 persona                                                                                                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://top-channel.tv/2026/09/28/baste-te-paligjshme-prane-shkollave-ne-tirane-zbulohet-aktiviteti-ne-6-lokale-dhe-arrestohen-8-persona/">https://top-channel.tv/2026/09/28/baste-te-paligjshme-prane-shkollave-ne-tirane-zbulohet-aktiviteti-ne-6-lokale-dhe-arrestohen-8-persona/</a> |
| BURIMI  | top-channel.tv                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHË


|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE     | 28 shtator 2026, 12:21:15 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                                                                                                                                                                                                                                          |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 12:17:00 UTC<br><i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën <b>text_date</b>. Dritarja: 28 shtator 2026, 12:16:00 UTC → 28 shtator 2026, 12:18:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 942289db70925797618fcc1f8e206091bcd32722f475397606a24993311d9327 |
| TEKSTI     | ab1f5e082f5f3e9cb63a1f9b46aa22ad4cfd4bf52e36ba30fa5ea5bed181ccff |
| PAMJA      | aa1af3f8d3cad5be0391e30fcfa56998ccef739df01731050753f6a197397c47 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 2c3e831520fba577c7d70a81eeecccd604cab9b1e6df36ac7c0a48ce98c27582                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2c3e831520fba577c7d70a81eeecccd604cab9b1e6df36ac7c0a48ce98c27582>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET TË FUNDIT

## Baste të paligjshme pranë shkollave në Tiranë, zbulohet aktiviteti në 6 lokale dhe arrestohen 8 persona

28/09/2026 14:17



Policia e Tiranës ka intensifikuar kontrollet pranë institucioneve arsimore për të parandaluar aktivitetet e paligjshme. Në kuadër të operacionit "Barriera", janë zbuluar 6 lokale ku zhvilloheshin lojëra fati të paligjshme.

Për këtë veprimtari janë arrestuar 8 persona. Gjatë operacionit janë sekuestruar 9 celularë dhe pajisje DVR, të përdorura për vendosjen e basteve sportive. Hetimet vijnë për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet.

"Tiranë. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë vijnë kontrollet dhe veprimet intensive për garantimin e sigurisë në dhe pranë institucioneve arsimore, si dhe për evidentimin dhe goditjen e veprimtarive të paligjshme që zhvillohen në këto zona.

Finalizohet operacioni i koduar "Barriera". Zbulohen 6 lokale ku luheshin lojëra fati.

Vihen në pranga 8 shtetas dhe sekuestrohen 10 pajisje.

Si rezultat i veprimeve hetimore, të kryera me metoda proaktive, nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Mashtrimeve Kibernetike, në koordinim me Prokurorinë, me objektiv parandalimin dhe goditjen e rasteve të përshtatjes së lokaleve, veçanërisht atyre në afërsi të institucioneve arsimore, për lojëra fati ilegale, me celularë, kompjuterë dhe/ose makineta, u finalizua në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit Nr. 2 dhe me shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale, operacioni i koduar "Barriera".

Në kuadër të këtij operacioni u zbulua se në 6 lokale në zona të ndryshme të kryeqytetit, në afërsi të shkollave, viheshin baste sportive, me celularë.

Për këto raste u arrestuan në flagrancë shtetasit M. M., 20 vjeç dhe S. A., 23 vjeç, punonjës në 2 prej lokaleve, si dhe shtetasit D. V., 24 vjeç; B. Ç., 42 vjeç; E. S., 43 vjeç; A. D., 26 vjeç; E. B., 24 vjeç dhe O. A., 21 vjeç, të cilët u kapën në flagrancë në ambientet e subjekteve, duke vënë baste.

Me cilësinë e provës materiale u sekuestruan nga këto ambiente, pajisje DVR dhe 9 celularë me faqe aktive për lojëra fati.

Hetimi dhe kontrollet vijnë për të identifikuar dhe nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetas të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë veprimtari të kundërligjshme.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme", shkruan Policia.

Top Channel

I Aktualitet »

## Kryesore



Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale...

12:39

Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme

08:29

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

08:25

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë

12:58

Shënoi në Wembley dhe udhëhoqi Spanjën, Lamine Yamal kërkon kurorën e futbollit botëror. Katalanasit këmbëngulin për "Topin e Artë"

09:37

## Më të lexuarat

Kreshnik Spahiu shpërthen ndaj burrave shqiptarë: Janë injorantë, vishen si arabë dhe jeta u vërtitet nga lavazhi te garazhi

E PLOTË/ "Si ka mundësi që nuk e dija?", mesazhi i Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Kam fajet e mia, por jam këtu për të bërë histori e jo pasuri

Exclusive/ Nga dhoma e hotelit me Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe

Ekskluzive/ Ministri Ferit Hoxha avancohet me rokadën e ambasadorëve, Denion Meidani shkon në Prishtinë, Petrit Malaj në Shkup

Asnjë shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj, Irlanda e kthen ndeshjen me Izraelin në një deklaratë simbolike

"Më ka ndaluar shërbimi sekret", ish-deputeti i PD flet për Top Channel pasi iu refuzua hyrja në RMV: Më nxorën një fletë, kërkuam që...

Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK



**Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje**

28/09 14:18



**"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF**

28/09 13:51



**FOTOLAJM/ Kreu i komanduar i SHISH shfaqet për herë të parë në Këshillin e Sigurimit Kombëtar, Elvis Lila me karrierë 20-vjeçare në Shërbimin e Inteligjencës**

28/09 13:29



**Nga Kavaja në Tiranë e Durrës/ Zbardhen 6 vjedhje automjete, arrestohen 2 persona**

28/09 13:14



**Media italiane: Rasti 'Veliaj' që vë në vështirësi Melonin, drejtësia shqiptare nën lupë**

28/09 13:00



**"Kishte pajisje të vjetra elektroshtëpiake"/ I moshuari u gjet i karbonizuar në banesën e djegur në Fier, policia zbardh shkaqet e ngjarjes së rëndë**

28/09 12:36

## Na ndiqni:



## I Video »



**Top News – Pasojat e rregullores së re të GJKKO. 'Bojkoti i avokatëve mund të lirojë kriminelët'**



**Top News – Drogë me taksì në shkollë. Gjykata e Tiranës lë në burg 31 të arrestuarit**



**Top News – '7 fëmijët e Ursulës, në një tavolinë'/Rama kërkon integrimin gradual: Ngurrimi ka pasoja**



**Top News- Takimi i orëve të vona me Kurtin/ PDK kërkon ligjin për specialen, 'më pas Presidentin'**



**Top News- Ukraina të kërkojë ndjesë! Zelenski zemëron Korenë e Veriut, zbuloi transferimin e robërve**



**Top News – Anija gjigante e SpaceX në orbitë / Starship 'ndeç motorin', pasoja të jashtëzakonshme**

## Lajme

Lajmet e fundit  
Politikë  
Kronikë  
Aktualitet  
Ekonomi  
Sociale  
Video  
Top News LIVE

## Bota

Opinion  
Koment  
Kosova dhe Rajoni  
Shkencë dhe Teknologji  
Auto

## Sport

Kombëtarja  
Kategoria Superiore  
Kategoria e Parë  
Premier League  
La Liga  
Serie A  
Shumësportësh  
Sport Gossip

## Pop News

Showbiz  
Lifestyle  
Fashion  
Shëndeti  
Dieta  
Receta gatimi

## Programe

Big Brother VIP  
Për'puthen  
Shqipëria LIVE  
Fiks Fare  
Video  
Të gjitha programet  
Guida TV

## Top Channel

Rreth Top Channel  
Kontakt  
Bileta – Portokalli  
Puno në Top Channel  
Privacy Policy & Terms of Use  
Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.